

Siguri

Ekskluzive | Dyshohet se tentoi t'i japë fund jetës me kallashnikov – 52-vjeçari nga Juniku përfundon në QKUK



Sinjali.com

02 Qershor 2026 09:40



Një ngjarje e rëndë ka ndodhur mbrëmjen e së hënës në Junik, ku një burrë dyshohet se ka tentuar t'i japë fund jetës duke përdorur një armë automatike, mëson ekskluzivisht Gazeta Sinjali.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se bëhet fjalë për Z.K, i cili është gjetur i plagosur me armë zjarri në Lagjen Berisha në Junik.

Sipas informacioneve të siguruara nga Sinjali, fillimisht Policia është njoftuar nga mjeku kujdestar i QKMF-së në Junik, i cili kishte dalë bashkë me ekipin mjekësor në vendngjarje për t'i ofruar ndihmë të plagosurit.

Kur zyrtarët policorë kanë arritur në shtëpinë e tij, ekipet emergjente po e trajtonin ende personin e plagosur, i cili më pas është transportuar me autoambulancë në Spitalin Rajonal "Isa Grezda" në Gjakovë, ndërsa për shkak të gjendjes së tij është transferuar në QKUK për trajtim të mëtejshëm.

Në vendngjarje kanë dalë komandanti i stacionit policor, hetuesit nga Juniku, hetuesit rajonale, krim-teknika rajonale dhe Prokurorja kujdestare për krime të rënda.

Gjatë ekzaminimit të vendit të ngjarjes, hetuesit kanë gjetur një armë automatike AK-47 në një automjet të parkuar në oborrin e shtëpisë, për të cilën dyshohet se është përdorur në rast.

Sinjali mëson se Policia ka sekuestruar armën, 47 fishekë që ndodheshin bashkë me të në automjet, katër fishekë të tjerë të gjetur brenda objektit, si dhe një predhë dhe një gëzhojë të të njëjtit kalibër.

Me udhëzim të Prokurorit të Shtetit, është iniciuar rasti për veprat penale "Tentim vetëvrasje" dhe "Mbajtje në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve".

Hetimet për rastin janë në vazhdim, ndërsa gjendja shëndetësore e të plagosurit nuk është bërë e ditur zyrtarisht.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.


/GazetaSinjali/

juniku


tentimvrasje

arme

Të tjera:



DnV: Në pjesën e dytë të ditës, dalje më e ulët për të votuar krahasuar me rundin e parë



Ndërtimi i rrugëve, një debat i pafund në Kosovë

Sociale



Këto janë tri komunat me më së shumti votues nga diaspora



AAK-PSD del e para në këtë komunë

Politikë

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtimi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera